

Analizë e shërbimeve të ofruara në Kosovë për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

SIT – Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime



Hulumtuese: **Leonita Berisha**

Qershor 2021

Ky raport u mundësua nga Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara UNFPA zyra në Kosovë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e SIT – Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNFPA-së ose Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Për OKB-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekst të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

Lista e akronimeve

DHBGJ - Dhuna me bazë gjinore;

DHF - Dhuna në familje;

DSHBK - Departamenti i Shëndetësisë i Burgjeve të Kosovës;

IFPK - Instituti i Forenzikës Psikiatrike të Kosovës;

KE - Këshilli i Evropës;

LMDHF - Ligji i Mbrojtjes nga Dhuna në Familje;

MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;

MSH - Ministria e Shëndetësisë;

PK - Policia e Kosovës;

QKSGJ - Qendra Kosovare për Studime Gjinore;

QPS - Qendra për Punë Sociale;

RRGK - Rrjeti i Grave të Kosovës;

SHKK - Shërbimi Korrektues i Kosovës;

SHSK - Shërbimi Sprovues i Kosovës;

UA - Udhëzimet Administrative;

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje

- | | |
|---|---|
| 1. Prapavijë e përgjithshme | 6 |
| 2. Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore në Kosovë | 7 |
| 3. Korniza ligjore | 8 |
| 4. Shërbimet për ushtrues të dhunës në Kosovë | 9 |

2. Metodologjia

- | | |
|------------------------------------|----|
| 1. Dizajni i studimit dhe mostrimi | 11 |
| 2. Mbledhja e të dhënave | 11 |
| 3. Analiza dhe rezultatet | 12 |
| 3. Diskutimi dhe rekomandimet | 15 |
| 4. Shënimet dhe referencat | 17 |

Abstrakti

Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore janë disa prej sfidave më të mëdha me të cilat përballen institucionet e Kosovës. Programet për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore janë elemente të rëndësishme të një qasjeje integruese dhe gjithëpërfshirëse në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Për të eksploruar shërbimet që ofrohen për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore u përdorën fokus grupet. Me përdorimin e analizës së përmbajtjes, disa kategori u vunë në pah: a) shërbimet në dispozicion (aktuale) për kryerësit e veprave të dhunës në familje

dhe dhunës me bazë gjinore, b) kohëzgjatja e shërbimeve për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, c) sfidat gjatë implementimit të shërbimeve për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, d) përparësitë për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore kur pranojnë këto shërbime, e) implementimi i ndryshimeve në shërbimet aktuale për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Të gjeturat e këtij studimi tregojnë se nuk ka shërbime specifike dhe programe me kurrikula, udhëzime, protokole, dhe standarde të qarta që targetojnë kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, të ofruara nga institucionet e Kosovës. Shërbimet në dispozicion që fokusohen në këshillim psikologjik dhe trajtim të abuzimit me droga janë të natyrës së përgjithshme, dhe nuk janë të përshtatura për nevojat e kryerësve të veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Fjalët kyçe:

dhuna në familje

dhuna me bazë gjinore

fokus grupe

shërbime rehabilituese për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Hyrje

Prapavijë e përgjithshme

jë e përgjithshme

Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore paraqesin çështje serioze të shëndetit publik global dhe shkelje serioze të të drejtave të njeriut. Dhuna në familje i referohet dhunës që ndodhë në mjedis shtëpiak, që nuk kufizohet në dhunë fizike. Ajo përfshin shumë forma të dhunës, duke përfshirë abuzimin verbal, abuzimin psikologjik dhe emocional, abuzimin ekonomik, abuzimin seksual dhe riprodhues dhe kontrollin shtrëngues (neni 3b, Konventa e Stambollit). Edhe pse burrat dhe gratë mund të jenë subjekt i dhunës në familje, gratë kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë në familje ku 30% e grave kanë raportuar përjetim dhune anembanë botës (OBSH, 2021). Dhuna me bazë gjinore i referohet dhunës ndaj grave, e cila ndodhë vetëm pse janë gra ose që i prekë gratë në mënyrë disproporcionale (neni 3a, Konventa e Stambollit). Rrjedhimisht, dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore kanë efekte të pafavorshme në jetët e grave, duke i bërë ato më të rrezikuara ndaj problemeve shëndetësore duke përfshirë probleme të shëndetit mendor si depresioni, abuzimi me alkool dhe probleme të shëndetit seksual dhe riprodhues.

Hulumtimet e mëhershme kanë dëshmuar se dhuna në familje është një problem kompleks shumë dimensional. Dhuna në familje është konceptualizuar si një fenomen me shumë aspekte, i ndërtuar mbi ndërveprimin e faktorëve personal, të situatës, dhe socio-kulturor. Siç është cituar nga Kelmendi (2014), mosha e re, niveli i ulët i shkollimit (Ackerson, Kawachi, Barbeau, & Subramanian, 2008; Chan, 2009; Johnson & Das, 2009), përjetimet e fëmijërisë të dhunës në familje dhe ndëshkimit trupor (O'Leary, Smith Slep, & O'Leary, 2007), dhe pajtimi me qëndrime seksiste, patriarkale, dhe/ose seksualisht armiqësore (Boyle, Georgiades, Cullen, & Racine, 2008; Tang & Lai, 2008) paraqesin parashikuesit më konsistent të dhunës në familje në nivel personal. Për më tepër, tipare të personalitetit që reflektojnë tipe të personalitetit agresiv, narcisist dhe antisocial përfaqsojnë faktorë rreziku për abuzim nga partneri (Carlson, Warden, Ryn & Bachman, 2003). Në nivel familjar, vështirësitë e hershme, abuzimi në fëmijëri, statusi i ulët ekonomik shoqëror dhe shëndeti i dobët kanë qenë të shoqëruara me dhunë në familje (Loxton, Townsend, Forder & Coomve, 2018). Flood & Pease (2009) kur rishqyrton literaturën sa i përket faktorëve që ndikojnë në qëndrimet ndaj dhunës kundër grave, gjetën që një faktor kyç në nivel të organizatës ka pjesëmarrja në kontekste mbështetëse të dhunës ndaj grave.

Në nivel të komunitetit, ata identifikuan që pjesëmarrja në grupe joformale të moshatarëve dhe rrjeteve formësojnë qëndrimet kundrejt dhunës ndaj grave. Së fundmi, në nivel shoqëror faktorët kyç që ndikojnë në qëndrimet kundrejt dhunës ndaj grave përfshijnë pornografinë dhe media të tjera, kampanja të edukimit me ndikime të mundshme duke përfshirë politikën dhe drejtësisë penale dhe lëvizjet shoqërore.

Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore në Kosovë

Kosova karakterizohet nga një strukturë patriarkale e familjes, normave shoqërore tradicionale dhe qëndrimeve kulturore konservative, të cilat kanë ndikuar negativisht tek të drejtat e grave për të pasur ndikim në fushën politike, ekonomike dhe shoqërore (USAID, 2016; Kosovo Gender and Power Dynamics Assessment). Përveç kësaj, këta faktorë janë reflektuar në çështjen e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, çështje e cila paraqet një shqetësim serioz dhe një prej sfidave kryesore me të cilën përballen institucionet e Kosovës. Në vitin 2008, Rrjeti i Grave të Kosovës eksplori pikëpamjet e shoqërisë kosovare mbi lidhjet e dhunshme, me fokus dhunën fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike ndaj grave, fëmijëve dhe të moshuarve, duke përdorur metodologji kuantitative. Rezultatet treguan se 20% e të anketuarve/ave janë përgjigjur me “pajtohem” ose “pajtohem deri diku” me deklaratën “Nganjëherë është në rregull që bashkëshorti t’u godasë bashkëshorten e tij”, ndërsa 74.9% prej tyre nuk u pajtuan. Më shumë se një e treta e të anketuarve/ave besuan se “Është e natyrshme që dhuna fizike ndodhë ndonjëherë kur një çift përllahet”. Për më tepër, 40% e pjesëmarrësve/eve u pajtuan se “Dhuna është një pjesë normale e çfarëdo lidhjeje, dhe shoqëria në përgjithësi, e pranon se dhuna ndodhë ndonjëherë” (41% e burrave dhe 37% e grave), ndërsa 20% e pjesëmarrësve deklaruan se është e pranueshme që bashkëshorti të godasë bashkëshorten e tij ndonjëherë (Farnsworth & Qosja-Mustafa, 2008, p. 2). Sa i përket dhunës seksuale, dy të tretat e të anketuarve/ave u pajtuan se “Marrëdhënia seksuale nuk mund të jetë kurrë dhunë nëse ndodhë mes dy të rriturve që janë të martuar”. Gjysma e të anketuarve/ave u pajtuan se goditja e fëmijëve me shuplakë kur është e nevojshme është e pranueshme. Raportimet për përjetimin e dhunës në familje gjatë jetës së tyre tregojnë se 46.4% e grave dhe 39.6% e burrave kanë përjetuar ndonjë lloj të dhunës në familje gjatë jetës së tyre. Sjellja e dhunshme iu atribua papunësisë (62.4%) dhe alkoolit (43%), ku 38.9% e të anketuarve/ave besuan se dhuna është “normale” ose e pranueshme rrethana të këtilla (Farnsworth & Qosja-Mustafa, 2008). Sa i përket vendimmarrjes financiare, më shumë se gjysma e të anketuarve (52.9%) raportuan se kjo është përgjegjësia e anëtarëve burra të familjes, ndërsa vetëm 10.7% raportuan se anëtarët gra ishin përgjegjëse për marrjen e vendimeve financiare për familjen.

Të dhënat për raportimin e dhunës në familje nga Policia e Kosovës në 5 vitet e fundit, tregojnë se në 2020 numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara nga gratë, burrat, fëmijët nën moshën 18 vjet, të moshuarit mbi moshën 60 vjet, dhe rastet recidiviste ishte më i larti i regjistruar. Në përgjithësi, u raportuan 2,069 raste të dhunës në familje. Nga këto, në 79% të rasteve, viktimat ishin gratë, 22.5% ishin burra, 5.8% ishin fëmijë nën moshën 18 vjet, të moshuar mbi moshën 60 vjeçare ishin 8.7%, dhe 4.6% ishin raste recidiviste.

Gjithsej, këto të gjetura dhe të dhëna treguan se dhuna në familje është një problem që i ka bërë ballë testit të kohës në shoqërinë e Kosovës dhe është e pranueshme në masë të madhe. Zërat dhe të drejtat e grave janë dytësore në familje krahasuar me ato të burrave. Proceset e vendimmarrjes i përjashtojnë gratë, duke i prirë pasigurisë financiare që i bën më të cënueshme ndaj dhunës. Më tutje, pavarësisht frikës dhe stigmës së raportimit të rasteve të dhunës në familje, ka një rritje në trendin e të kërkuarit të ndihmës nga Policia e Kosovës nga gratë, burrat, fëmijët, dhe të moshuarit në tre vitet e fundit.

Korniza ligjore

Që nga viti 2008, institucionet e Kosovës kanë vazhduar të përmirësojnë të drejtat e njeriut me anë të legjislacionit dhe politikave të brendshme që merren me pabarazitë gjinore dhe dhunën në familje. Në vitin 2010 hyri në fuqi Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 3L/182 (LMDHF), me qëllim parandalimin e dhunës në familje në të gjitha format nëpërmjet masave ligjore dhe sigurimit të trajtimit të kryerësve të veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Ky ligj rregullon masat mbrojtëse për viktimat (nenet 5,6,7,8) dhe ofron definicionet e obligimeve të autoriteteve kompetente. Për më tepër, vendos trajtim psikosocial (neni 4) dhe trajtim për abuzim me alkool dhe droga (neni 9). Në përputhje me Konventën e Stambollit, pjesëtarët/et e familjes ose të njësisë familjare të cilët mund të pranojnë mbrojtje dhe mbështetje përfshijnë bashkëshortin/en apo partnerin/en e tanishëm/e ose paraparak/e, pa marrë parasysh nëse ata/o jetojnë apo kanë jetuar ose jo në një shtëpi në të kaluarën [neni 2 (1,3)]. Me qëllim që të rregullohen tutje këto masa, janë shkruar Udhëzimet Administrative nr.12/2012 dhe nr.02/2013. Sipas kornizës së tanishme ligjore, gjykata civile mund të imponojë trajtim për abuzim me alkool dhe substanca psikotrope deri në dy vjet. Institucionet që mund të ofrojnë këtë trajtim janë Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (kujdesi shëndetësor primar), spitalet regjionale, Qendrat e Shëndetit Mendor (kujdesi shëndetësor dytësor), dhe institucionet si Insituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK). Trajtimi psiko-social zgjatë deri në gjashtë muaj dhe ofrohet nga profesionistë/e të licensuar/a nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Ministria e Shëndetësisë e Kosovës. Ky trajtim nuk është i vlefshëm për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore me histori të diagnozës psikiatrike që duhet të trajtohen në institucione shëndetësore. Pavarësisht se kjo paraqiti një hap shumë të rëndësishëm në zhvillimin e legjislacionit sa i përket dhunës në familje, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe aktet nënligjore janë kritikuar në të kaluarën (Misioni i OSBE-së në Kosovë, 2012). Është vlerësuar që Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në të kaluarën nuk ka marrë parasysh që gratë janë të prekura nga dhuna në familje në mënyrë disproporcionale, duke pasur qasje gjinore neutrale.

Përveç kësaj, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe aktet e tij nënligjore janë kritikuar për fokusin e tyre në varësinë ndaj substancave dhe çrregullimet psikologjike si shkaqe kryesore të dhunës në familje, duke mos adresuar dinamikën gjinore dhe sfiduar perceptimet e burrave kryerës të veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinoreve mbi të drejtën për të kontrolluar dhe dominuar partneret e tyre (Rrjeti i Grave të Kosovës, 2015). Dy strategji që vendosin veprime konkrete për institucionet që punojnë në fushën e dhunës në familje janë zhvilluar: Programi dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje i Kosovës 2011-2014, i përshtatur më 2011, dhe Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020 (SKMDHFPV), i pranuar më 30 dhjetor 2016. SKMDHFPV u draftua duke u bazuar në të gjeturat dhe rekomandimet e vlerësimit të programit paraprak (Ministria e Drejtësisë, 2015). Në mes tjerash, raporti vuri në pah implementim të limituar në nivel qendror dhe lokal të akteve nënligjore të Konventës së Stambollit që rregullojnë organizimin e programeve të targetuara për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinoreit (neni 16, paragrafi 1) dhe dhunë seksuale (neni 16, paragrafi 2). Konventa e Stambollit konstaton që programet e tilla nuk mund të konsiderohen si opsion, por si shtesë ndaj sanksioneve efektive, proporcionale dhe dekurajuese (neni 45, Konventa e Stambollit). Specifikisht, u gjet se vetëm disa prej kryerësve të veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore pranuan trajtim si pasojë e “mungesës totale të infrastrukturës”. Më tutje, mungesa e programeve rehabilituese bëri që gjykatësit/et të mos e përshkruajnë këtë masë mbrojtëse.

Shërbimet për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë

Më 2017, zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë kreu një studim me qëllim promovimin standardeve të Këshillit të Evropës për përmirësimin e parandalimit të dhunës, mbrojtjen e viktimave, ndjekjen penale të kryerësve, dhe hartëzimin e shërbimeve ekzistuese për gra viktime të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit. Ky studim adresoi disponueshmërinë dhe qasshmërinë e shërbimeve mbështetëse që i përgjigjen dhunës ndaj grave, dhe disponueshmërinë e programeve për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë, në përputhje me Konventën e Stambollit. Të dhënat u mbledhën duke administruar pyetësorë dhe intervista me institucione publike dhe organizata jo qeveritare. Rezultatet e tyre treguan që vetëm 15 ofrues të shërbimeve (28%) raportojnë se puna që ndërmarrin me kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore është pjesë e shërbimeve të tyre të përgjithshme. Nga këta ofrues të shërbimeve, 11 ishin Qendra për Punë Sociale (QPS), dy ishin Qendra për Shëndetin Mendor, dhe një ishte Instituti i Forenzikës Psikiatrike të Kosovës (IFPK). Këshillimi për çifte dhe psikoterapia/këshillimi për familje ishin prej shërbimeve më të shpeshta të ofruara (14 dhe 13 shërbime). Ndërmjetësimi u ofrua poashtu nga 12 shërbime, duke përfshirë strehimoret e grave. Forma më e rrallë e mbështetjes ishte menaxhimi i zemërimit dhe asistencë në gjetjen e punësimit. Përveç kësaj, forma më e shpeshtë e dhënies së shërbimeve ishte në baza individuale (14 shërbime), ndërsa mbështetja në grup ishte e ofruar nga katër institucione.

Megjithatë, nuk u gjetën prova të programeve për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore me planprograme, udhëzime, protokole dhe standarde të qarta. Programet për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore janë elemente të rëndësishme të një qasje integruese dhe gjithëpërfshirëse në luftimin e dhunës ndaj grave, e cila nga ana e saj duhet të jetë pjesë e një politike ose strategjie kombëtare gjithëpërfshirëse. Që nga viti 1980, puna me kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore që është fokusuar në sigurinë e grave dhe parandalimin e dhunës në familje gjithnjë e më shumë është bërë më e njohur si një element kyç i shërbimeve mbështetëse për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore (Hester & Lilley, 2014). Duke pasur parasysh seriozitetin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, rëndësinë e shërbimeve për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore të ofruara nga institucionet, si dhe sasia e pakët e dëshmimeve shkencore që eksplorojnë shërbimet për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në kontekstin e Kosovës, objektivat e këtij hulumtimi janë:

- – *hartëzimi i shërbimeve institucionale që punojnë me kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;*
- – *marrja e të dhënave që do të ndihmojnë të adresojnë sfidat me të cilat institucionet përballen gjatë ofrimit të shërbimeve për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.*

Metodologjia

Dizajni i studimit dhe mostrimi

Për të eksploruar shërbimet e tanishme në dispozicion për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore të ofruara nga institucionet e Kosovës u përdor metodologji kualitative. Duke përdorur mostrim të qëllimshëm, 11 zyrtarë/e nga 10 institucione qeveritare dhe jo-qeveritare u selektuan për pjesëmarrje. Ata/o u kontaktuan nëpërmjet email-it dhe telefonit. Kriteri për pjesëmarrje ishte që pjesëmarrësit/et të jenë zyrtarë/e ekzekutivë/e nga: a) institucione qeveritare që ofrojnë shërbime për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe/ose b) organizata jo-qeveritare të përfshira në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Këto përfshijnë: Policinë e Kosovës, Gjykata Themelore e Prishtinës, Zyra e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Shëndetësisë i Burgjeve të Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, UN WOMEN Kosovë dhe Rrjeti i Grave të Kosovës. Mostra finale ishte e përbërë nga 7 pjesëmarrës/e (N=7), katër gra dhe tre burra nga këto institucione: Policia e Kosovës, Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti i Shëndetësisë i Burgjeve të Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, dhe Rrjeti i Grave të Kosovës.

Mbledhja e të dhënave

Si pasojë e kufizimeve për shkak të pandemisë, dy fokus grupe u mbajtën virtualisht nëpërmjet platformës Zoom. Fokus grupi i parë u mbajt më 18 mars 2021, në të cilin morën pjesë tre pjesëmarrës/e dhe zgjati një orë. Fokus grupi i dytë u mbajt më 24 mars 2021 me katër pjesëmarrës/e, dhe zgjati dy orë. Shtatë pyetje u shtruan nga hulumtuesja për të nxjerrë informacione mbi shërbimet e ofruara nga institucionet qeveritare për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, kohëzgjatjen e tyre, sfidat me të cilat këto institucione përballen në implementimin e këtyre shërbimeve, përparësitë që kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore i kanë me marrjen e këtyre shërbimeve, përmirësime të mundshme dhe aktivitete që mund të përmirësojnë këto shërbime në të ardhmen.

Analiza dhe Rezultatet

Analiza e përmbajtjes dha këto domene: (a) shërbimet në dispozicion për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, (b) kohëzgjatja e shërbimeve për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, (c) sfidat në implementimin e shërbimeve për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, (d) përparësitë që kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore kanë kur i pranojnë këto shërbime, dhe (e) implementimi i ndryshimeve në shërbimet e disponueshme për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Tabela 1. ilustron domenet dhe kategoritë. Të dhënat janë të prezantuara varësisht nga domeni, pastaj kategoria.

Të dhënat janë përmbledhur duke i mbledhur numrin e herave që një temë është përmendur, pa marrë parasysh se cili/a pjesëmarrës/e e ka përmendur, ose nëse është përmendur më shumë se njëherë nga një pjesëmarrës/e. Të gjitha kategoritë janë të ilustruara nga citimet e pjesëmarrësve/eve.

Tabela 1.

Domenet dhe kategoritë përkatëse	Frekuenca
Shërbimet në dispozicion për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore	
● Shërbimet e shëndetit mendor të ofruara në burg	9
● Shërbimet mjekësore të ofruara nga Policia e Kosovës kur ka lëndime	1
● Shërbimet ligjore	8
● Aktivitetet korrektuese dhe arsimore	13

Domenet dhe kategoritë përkatëse	Frekuenca
Kohëzgjatja e shërbimeve në dispozicion për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore	
● Kohëzgjatje të caktuar	5
● Kohëzgjatje të pacaktuar	2
Sfidat në implementimin e shërbimeve në dispozicion për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore	
● Mungesa e aktiviteteve edukative për të burgosur	1
● Vështirësi në mbledhjen e materialeve të rasteve	10
● Konteksti i punës dhe çështjet e sigurisë	6
● Faktorët socio-ekonomik dhe faktorët familjarë	9
● Ruajtja e konfidencialitetit të burgosurve të mitur	2
● Mungesa e stafit	5
● LMDHF është i çalë	3
● Kufizimet e pandemisë	2
● Mungesa e fondeve afatgjate	3
● Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit institucional	8
● Mungesa e njohurisë për dhunën në familje	3
● Zyrtarë me sfond jo të duhur arsimor	1
● Kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore me probleme të shëndetit mendor	6
● Recidivizmi	3

Domenet dhe kategoritë përkatëse	Frekuenca
Përparësitë që kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore fitojnë kur ju ofrohen këto shërbime	
● Kualifikime edukative	3
● Riintegrimi në shoqëri	5
● Trajtimi për abuzim me droga	4
Implementimi i ndryshimeve në shërbimet në dispozicion për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore	
● Ndryshime të nevojshme në ligje	2
● Ofrimi i mësimi universitar online në qendrat korrektuese	1
● Ndryshime të nevojshme në institucionet e tyre	2
● Ngritja e kapaciteteve	1
● Rritja e vetëdijësimit dhe besimit të qytetarëve në institucione	4
● Implementimi efektiv i ligjit	3
● Rritja e bashkëpunimit	2
● Planifikimi financiar	1
● Krijimi i programeve të rehabilitimit për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore	3
● Përfshirja e familjes në trajtim	2

Shërbimet në dispozicion për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe kohëzgjatja e tyre

Në përgjithësi, pjesëmarrësit/et raportuan një gamë të gjerë të shërbimeve sa i përket fush-ëveprimit dhe kohëzgjatjes duke përfshirë shërbime të shëndetit mendor dhe fizik të ofruara në mjedis të burgut, shërbime ligjore, aktivitete korrektuese dhe edukative. Megjithatë, këto shërbime ishin të natyrës së përgjithshme dhe nuk ishin të targetuara specifikisht tek grupi i kryerësve të veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinoreve. Nuk u gjet dëshmi e programeve me kurrikula, udhëzime, protokole dhe standarde të qarta.

“Shërbimi i shëndetit mental ofrohet për çdo të burgosur të pranuar në burg, dhe është obligativ. Është obligim ligjor për neve, i cili rregullohet me ligjin për mbrojtjen dhe nëpërmjet procedurave dhe standardave të brendshme... Duke u bazuar në vlerësimin e parë nga një psikolog ose psikiatër, frekuenca e sesioneve psikologjike vendoset. Nëse trajtimi intenziv është i nevojshëm atëherë, kjo bëhet dy ose tri herë në javë. P.sh. rastet të cilat është rrezik për kryerjen e vetëvrasjes ose lëndimin e psikologut, seancat mbahen katër herë në javë... Është edhe një rregull tjetër që çdo gjashtë muaj çdo i burgosur duhet t'i nënshtrohet vlerësimit psikologjik”

(Departamenti i Shëndetësisë i Burgjeve të Kosovës)

“Ne i bëjmë raportet për prokurori. Zakonisht neve na kërkohen edhe karakteristikat e të miturit, rrethanat e familjes ku është rritur ai i mitur”

(Shërbimi Sprovues i Kosovës)

Është me rëndësi të ceket që shërbimet për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore duhet të shkojnë përtej trajtimit të tyre për probleme psikologjike dhe të varësisë, dhe të ju ofrohen shërbime që janë të qëlluara për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore; të eksplorojnë pasojat e sjelljeve të tyre jo të duhura në viktimat e tyre, duke rritur përgjegjësinë dhe sfiduar stereotipet gjinore.

Sfidat në implementimin e shërbimeve për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Pjesëmarrësit/et listuan një shumëllojshmëri të sfidave me të cilat përballen në implementimin e shërbimeve që ofron institucioni i tyre. Më të zakonshmet ishin: vështirësi në mbledhjen e materialeve të rasteve nga institucionet bashkëpunuese, faktorë socio-ekonomikë dhe familjarë, mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit institucional, konteksti i punës dhe çështje të sigurisë dhe problemet e shëndetit mendor tek kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

"Zakonisht për të lehtësuar këtë dhe për të pasur qasje më të mirë, është më mirë për të punuar si zinxhir duke përfshirë familjen dhe institucione tjera. Por fatkeqësisht në Kosovë, ka mungesë të qasjes tek gjykatësit, prokurorët dhe institucione tjera. Kjo mbetet një shqetësim sepse për të implementuar këto masa bashkëpunimi me çdo institucion të përfshirë është i nevojshëm... Shumicën e kohës gjatë vizitës në familjen e të miturit, ne kemi observuar se ata vijnë prej një familjeje të varfër... ka njerëz me edukim superior dhe nuk kanë të ardhura, kështu duke ndikuar se si rritet fëmija dhe në edukimin e tij... Me siguri një prej sfidave më të mëdha është qasja në familje në mënyrën e duhur. Sepse kur je e frikësuar, normal që mundohesh t'i kryesh intervistat sa më shpejt që është e mundur..." (Shërbimi Sprovues i Kosovës)

"Ka shumë raste kur duhet të përsëritet kërkesa për anamneza sociale. Gjashtë muaj kalojnë dhe anamneza nuk dërgohet. Të duhet ta ridërgosh kërkesën... sa i përket zyrës së mbrojtjes së viktimave, unë e kam thënë edhe më herët dhe do e them prapë: ata janë të papërgatitur. Rastet vijnë të pakompletuara dhe mbrojtja e viktimave bëhet në mënyrë joprofesionale..." (Gjykata Themelore e Prishtinës)

Përparësitë që kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore kanë kur ju ofrohen këto shërbime

Pjesëmarrësit/et raportuan tri kategori të përparësive që kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore kanë kur kanë qasje në këto shërbime: kualifikime arsimore, riintegrim në shoqëri dhe trajtim për abuzim me droga. Trajtimi për abuzim me droga është i ofruar në bashkëpunim me organizatën "Labyrinth".

"E para, të gjithë të rinjtë të cilët janë të interesuar për shkollimin fillor dhe të mesëm përmes departamenteve komunale të arsimit dhe paraleleve të ndara që kemi ne qendrat korrektuese ju mundësojmë shkollimin. Benefit i atyre të rinjëve që janë të interesuar të shkollohen, me viju procesin mësimor është se ngjashëm si kundër që zhvillohet procesi mësimor në shkolla amë, ngjashëm zhvillohet procesi mësimor në paralelet e ndara nëpër burgje... ne kemi nxënëse që vijnë procesin mësimor dhe në fund të vitit pajiset me dëftesë... Ajo diplomë, nuk lëshohet nga shërbimi korrektues i Kosovës, po lëshohet nga Drejtorati Komunal për Arsim. Askund në dokumentacionin e personave të privuar nga liria nuk figuron se vijimin e shkollimit e ka bërë në institucione korrektuese..."

(Shërbimi Korrektues i Kosovës)

Implementimi i ndryshimeve në dispozicion për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Të gjithë/a pjesëmarrësit/et raportojnë nevojën për ndryshime në institucionet e tyre dhe në shërbimet që ata/o ofrojnë. Ata/o konstatojnë që këto ndryshime duhet të rregullohen me ligjet përkatëse. Përveç kësaj, ata/o vënë në pah nevojën për koordinim dhe bashkëpunim më të fortë në mes organizatave qeveritare dhe jo-qeveritare.

Ndoshta eventualisht sensibilizim më i madh, unë e di që ka fushata të vazhdueshme në raport me parandalimin e dhunës në familje... të vazhdojmë edhe më tepër me sensibilizim për shkak se kjo shoqëri ka edhe telashe tjera sociale si papunësia..."

(Gjykata Themelore e Prishtinës)

Është e vërtetë se ka vend për shumë ndryshime, por të gjitha ato në një mënyrë janë të kufizuara edhe me një kosto financiare e që shpeshherë ne ngelim pa i përmbushur disa obligime për sa i përket procesit që ka të bëjë me trajtimin e të burgosurve dhe të miturve, dhe në këtë aspekt neve na mungojnë shumë punëtori profesionale ku përmes tyre normal që kishim arritë që t'i aftësojmë dhe t'i trajtojmë personat e privuar nga liria në mënyrë që pas përfundimit të vuajtjes së dënimit të ketë një profesion të vetin dhe në sajë të përvojës që krijon në këto punëtori të gjenden në ekonominë e tregut. Në këtë aspekt edhe Ministria e Drejtësisë edhe Shërbimi Korrektues i Kosovës krahas sigurisë do të duhej të përkushtohen në çështjen e trajtimit të burgosurve edhe të miturve... Me buxhetet e tona që i kemi jemi larg përmbushjes së detyrave edhe objektivave tona sepse një shembull po e them që nga viti 2017 në vazhdimësi i furnizojmë bibliotekat tona nga orgnizatrat jo-qeveritare dhe nga institucionet tona, e asnjëherë nuk kemi arritë që të ndajmë mjete për furnizimin e bibliotekave tona me tekste, tituj, dhe ekzemplarë të ndryshëm...

(Shërbimi Korrektues i Kosovës)

Diskutimi dhe Rekomandimet

Në 20 vitet e fundit, në Kosovë nuk ka pasur përpjekje për të konsoliduar punën me kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe vështirësitë në sigurimin e financimit të qëndrueshëm, dhe mungesa e kërkesave ligjore kanë rezultuar në dorëzim të fragmentuar. Për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore të dënuar për dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore përbrenda mjediseve të burgjeve, mund të sajohen programe individuale për të adresuar nevojat e tyre. Modulet në dispozicion, p.sh përfshijnë teknikat e mësimi të sjelljeve jo-agresive në familje, menaxhimin e zemërimit, dhe kontrollin për të zvogëluar sjelljen agresive. Për më shumë, seancat e këshillimit individual të targetuara drejt kryerësve të veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore janë ofruar që nga viti 2018 nga organizata SIT. Module për programe për ndryshim të sjelljes për kryerësit e dënuar të veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore do të zhvillohen për hapje nëpër disa institucione dhe burgje në Kosovë në të ardhmen në bashkëpunim me SIT.

Standardi i vendosur nga Konventa e Stambollit në nenin 15 është i një iniciative dhe trajnimi sistematik në shërbim të profesionistëve që merren me kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore të të gjitha akteve të dhunës. Trajnimi i cili kërkohet duhet të mbulojë parandalimin dhe zbulimin e dhunës së tillë, barazinë mes grave dhe burave, nevojat dhe të drejtat e viktimave, dhe parandalimin e viktimizimit sekondar.

SIT inkurajon të gjitha autoritetet në Kosovë të sigurojnë:

- a. Ofrimin e burimeve adekuate për programet ekzistuese për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, me qëllim sigurimin e vazhdimsisë së punës tyre në mënyrë të qëndrueshme, sidomos ato në mjedise jo të burgjeve;
- b. Një rritje të numrit të programeve vullnetare për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore që kanë kryer dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore;
- c. Që të gjitha programet të implementojnë standarde uniforme të cilat vënë në qendër sigurinë dhe mbështetjen e të drejtave të njeriut të viktimave duke bashkëpunuar për së afërmi me shërbime të veçanta për mbështetjen e viktimave siç kërkohet nga neni 16, paragrafi 3, në Konventën e Stambollit;

- d. Që këto programe të ndiqen në masë të madhe, duke përfshirë inkorporimin e tyre në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë shërbimin e lirimit me kusht, ose duke prezantuar skema të stimulimit, si mjet për të ulur recidivizmin;

- e. Që të bëhen ndryshimet e nevojshme në legjislacion që t'ua mundësojnë prokurorëve/eve dhe gjyqtarëve/eve të referojnë kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore tek qendra të certifikuar për këshillim të kryerësve të veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për të kontribuar në parandalim terciar.



Shënime

Udhëzimi Administrativ nr.02/2013 për metodat e trajtimit të kryerësve të veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, ndaj të cilëve është imponuar masa obligative për trajtim mjekësor për alkoolizëm dhe varësi ndaj substancave psikotrope

Udhëzimi Administrativ nr.12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrave të trajtimit psikosocial për kryerësit e veprave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Neni 3a, Konventa e Stambollit

Neni 3b, Konventa e Stambollit

Referencat

Ackerson, L. K., Kawachi, I., Barbeau, E. M., & Subramanian, S. V. (2008). Effects of individual and proximate educational context on intimate partner violence: A population-based study of women in India. *American Journal of Public Health, 98*, 507-514 doi:10.2105/AJPH.2007.113738

Boyle, M. H., Georgiades, K., Cullen, J., & Racine, Y. (2008). Community influences on intimate partner violence in India: Women's education, attitudes toward mistreatment and standards of living. *Social Science & Medicine, 69*, 691-697

Carlson, B. E., Worden, A. P., Ryn, M., & Bachman, R. (2000). Violence against women: Synthesis of research for practitioners. National Institute of Justice, U.S. Department of Justice. Retrieved from <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/grants/199577.pdf>

Chan, K. L. (2009). Sexual violence against women and children in Chinese societies. *Trauma, Violence, & Abuse, 10*, 69-85. doi:10.1177/1524838008327260

Dutton, D. G., Saunders, K., Starzomski, A., & Bartholomew, K. (1994). Intimacy, anger and insecure attachment as precursors of abuse in intimate relationships. *Journal of Applied Social Psychology, 24*, 1367-1386. doi:10.1111/j.1559-1816.1994.tb01554.x

Flood, M., & Pease, B. (2009). Factors influencing attitudes to violence against women. *Trauma Violence Abuse, 10*, 125-142

Heise, L. (1998). Violence against women: An integrated ecological framework. *Violence Against Women, 4*, 262-290. doi:10.1177/1077801298004003002

Heise, L., & Garcia-Moreno, C. (2002). Violence by intimate partners. In E. Krug, L. Dahlberg, J. A. Mercy, A. B. Zwi, & R. Lozano (Eds.), *World report on violence and health* (pp. 87-121). Geneva, Switzerland: World Health Organization

Johnson, K. B., & Das, M. B. (2009). Spousal violence in Bangladesh as reported by men: Prevalence and risk factors. *Journal of Interpersonal Violence*, 24, 977-995. doi:10.1177/0886260508319368

Kelmendi, K. (2014). Domestic Violence Against Women in Kosovo. *Journal of Interpersonal Violence*, 30(4), 680–702. doi:10.1177/0886260514535255

Law No.03/L-182 on Protection against Domestic Violence

Loxton, D., Townsend, N., Forder, P., & Coombe, J. (2018). Domestic violence, risk factors and health. Australian Longitudinal Study on Women's Health Research Centre for Generational Health and Ageing. University of Newcastle. <https://plan4womenssafety.dss.gov.au/wp-content/uploads/2019/03/domestic-violence-risk-factors-and-health-2018.pdf>

Ministry of Justice (2015). Evaluation report of the Kosovo Program against Domestic Violence and Action Plan 2011-2014. Prishtinë/Priština. (Mapping)

Mirrlees-Black, C. (1999). Domestic violence: Findings from a new British Crime Survey self-completion questionnaire (Home Office Research Study 191). London, England: Home Office

O'Leary, D. K., Smith Slep, A. M., & O'Leary, S. G. (2007). Multivariate models of men's and women's partner aggression. *Journal of Consulting and Clinical Psychology*, 75, 752-764. doi:10.1037/0022-006X.75.5.752

OSCE Mission in Kosovo (2012). Adjudication of petitions for protection orders in domestic violence cases in Kosovo. <http://www.osce.org/kosovo/88713?download=true>

Qosaj-Mustafa, A., & Farnsworth, N. (2009). "More than words on paper?" The response of justice providers to domestic violence in Kosovo. United Nation Development Fund, Women's Safety and Security Initiative, UNDP, Prishtina, Kosovo

Taft, C. T., Bryant-Davis, T., Woodward, H. E., Tilman, S., & Torres, S. E. (2009). Intimate partner violence against African American women: An examination of socio-cultural context. *Aggression and Violent Behavior*, 14, 50-58. doi:10.1016/j.avb.2008.10.001

USAID (2016). Kosovo Gender and Power Dynamics Assessment. http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00MCRZ.pdf

WHO (2021). Global, regional and national estimates for intimate partner violence against women and global and regional estimates for non-partner sexual violence against women

Pasqyrë e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve për punën me kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë

Qëllimet:	Rastet për vit	Kategoritë e shpenzimeve	Total €
Dhuna në familje: dhuna fizike, psikologjike, dhe seksuale nga një burrë/grua kundrejt partnerit/es të tij/saj. 40-60 kryerës burra/gra të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore që kanë pranuar shërbime të këshillimit, që kontribuon në ndalimin e ushtrimit të dhunës nga ana e tyre	<ol style="list-style-type: none"> 1. 2 – 5 raste për muaj (80-150 sesione të këshillimit) 2. 24 - 60 raste për vit (384 – 1440 sesione të këshillimit) 	Sesione të këshillimit (6 këshillues ofrojnë shërbime këshillimi për kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore gjatë një viti në tri rajone: Prishtinë, Mitrovicë Jugore, dhe Gjilan)	72,000.00
Sesione të mbikëqyrjes/trajnitimit		Ndërtimi i bazave për konsolidimin e profesionistëve të çertifikuar të fushës. Trajnim dhe mbikëqyrje profesionale dhe psikologjike të këshilluesve të kryerësve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga një ekspert	6,000.00
Dhuna kundër grave/burrave, me fokus në dhunën ndaj partnerit/es (rehabilitimi dhe riintegrimi i kryerësve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore)		Mbështetja e tri (3) qendrave në punën me kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore – një qendër që tashmë është e themeluar, dhe themelimi i dy qendrave të tjera	36,000.00
Këshilluesit e qendrës ofrojnë shërbime të këshillimit për kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore		Qendrat e këshillimit – shërbimet e OJQ-ve, këshilla ligjore, etj.	15,000.00
2 këshillues të pavarur që përforcojnë kapacitetet e qendrës		Linjat e ndihmës për burrat dhe djemtë, telefonata të pranuar nga qendra e akredituar	12,000.00
Këshilla online për njerëzit që kërkojnë mbështetje		Krijimi i një platforme të këshillimit	8,000.00

Pasqyrë e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve për punën me kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë

Qëllimet:	Rastet për vit	Kategoritë e shpenzimeve	Total €
Ngritja e vetëdijësimit për rolin e burrave në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe në programet efektive të trajtimit të kryerësve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë në nivel publik dhe të komunitetit.		Fushata të ngritjes të vetëdijësimit për punën me djem dhe burra për të promovuar barazinë gjinore dhe përpilimi i broshurave dhe fletushkave informative. Inkurajimi dhe promovimi i implementimit të praktikave më të mira në punën me kryerësit e dhunës në Kosovë, si një prej masave efektive në luftën kundër dhunës.	15,000.00

Shpenzimet totale për vit:

164,000.00€